

PYETJE DHE PËRGJIGJE NGA LËNDA E HISTORISË

1. Kur dhe ku u lind Gjergj Kastrioti, kush ishin prindërit e tij?



Skënderbeu

Gjergj Kastrioti ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit dhe i princeshës Vojsava, fëmija i fundit midis 4 djemve dhe 5 vajzave. Mendohet se u lind më 6 maj 1405 në Krujë. U mor peng nga pushtuesit osman që në moshë të mitur (9-vjeçare) dhe u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Atje, zgjuarsia dhe shkathtësia e çuan Gjergjin në shkollën ushtarake të sulltanit që përgatiste komandantë. Është Hero Kombëtar i shqiptarëve, figura më e shquar në historinë e shqiptarëve.

2. Në cilin muaj dhe vit u kthye Skënderbeu në Krujë?



Kështjella e Skënderbeut në Krujë.

Skënderbeu u kthye në Krujë më 28 nëntor të vitit 1443. Ai nuk e harroi kurrë Atdheun e tij të dashur dhe priti me padurim rastin të kthehej në tokën që e lindi. Më 3 nëntor 1443 në afërsi të Nishit, Skënderbeu la ushtrinë turke dhe së bashku me 300 kalorës shqiptarë e me të nipin Hamza Kastrioti u kthye së pari në Dibër, ku populli e priti si çlirimtar e pastaj vajti në Krujë ku mori në zotërim trojet dhe kështjellën e babait.

3. Cili është emri i vërtetë i Skënderbeut?

Emri i vërtetë i Skënderbeut është Gjergj. Skënder ose Iskander është versioni turk i emrit Aleksandër. Sipas legjendës trimëria dhe aftësia e tij në artin ushtarak u shfaq herët dhe për këtë arsye turqit i vunë emrin Iskanderbej. Në oborret europiane të kohës njihesh me tepër me këtë emër, këtë e dëshmojnë edhe veprat e shumta mesjetare të shkruara për te (kompozitori i famshëm Antonio Vivaldi, në vitin 1718 vuri në skenë operën "Scanderbeg").

4. Kur dhe ku u mbajt Kuvendi i Lezhës?



Kuvendi i Lezhës

Kuvendi i Lezhës u mbajt më 2 mars 1444 në Lezhë. Lidhja e Lezhës ishte një aleancë politike ushtarake, si e tillë e para në historinë shqiptare. Pjesëmarrës të Kuvendit ishin, veç Skënderbeut, edhe Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Nikollë Dukagjini, Teodor Muzaka etj. Për shumë shekuj ky Kuvend merret si shembull i organizimeve të kuvendeve me tipare demokratike shqiptare. Kuvendi respektoi mendimet e pleqërisë shqiptare dhe zgjodhi për prijës Skënderbeun.


5. Kur u bë shpallja e pavarësisë së Kosovës?



Më 17 shkurt 2008 në Parlamentin e Kosovës u shpall Pavarësia e vendit tonë.

Më 17 shkurt 2008 shqiptarët e trojeve tona etnike dhe shqiptarët e diasporës ishin tubuar në Prishtinë për të festuar me krenari e dhembje ditën e Pavarësisë. Dita e parë e pavarësisë sonë u festua njëkohësisht edhe në Europë e Amerikë. Në Suedi, shqiptarët mbushën rrugët e qyteteve me parakalime të gëzuara, me vetura të stolisura me flamuj kombëtar, suedezë e amerikanë. 28 Nëntori 1912 e 17 shkurti 2008 janë dy pikat kulmore të referencës sonë historike për të kaluarën e dhembshme dhe themelet e sigurta për lirinë e përjetëshme të shqiptarëve.

6. Kur hyri në fuqi Kushtetuta e parë e Republikës së Kosovës?



Ballina e librit të Kushtetutës sonë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi me 15 qershor 2008.

Ja Preambula e Kushtetutës sonë:

”Ne, Populli i Kosovës, Të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet; Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit; Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social; Të sigurt që shteti i Kosovës do të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë Evropës, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje; Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë; Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruuese Euro-Atlantike; Në mënyrë solemne, miratojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.

7. Pse Papa i Romës e cilësoi Skënderbeun “Mbrojtës të Krishterimit”?



Vatikani

Papa i Romës e cilësoi Skënderbeun “Mbrojtës të krishterimit” për meritat e tij në luftë për mbrojtjen e Europës së krishterë nga perandoria osmane.

8. Kur vdiq Skënderbeu?



Skënderbeu vdiq më 17 janar 1468 në moshën 63 vjeçare. Kuntin e vdekjes para popullit e dha herët në mëngjesin e 17 janarit Lekë Dukagjini. Skënderbeu u varros në Lezhë i mbuluar me lavdi. Shqipëria luftoi edhe dhjetë vite kundër sulltanëve pastaj ra në terrin robërues pesëqindvjeçar. Varri i Skënderbeut ndodhet në Lezhë në këtë vend që duket në foto e që vizitohet nga mijëra vizitor.


9. Kush është autori i parë i “Historisë së Skënderbeut”?



Ballina e “Historisë së Skënderbeut.”


Autori i parë i historisë së Skënderbeut është Marin Barleti. Kur ra Shkodra, Barleti u shpërngul në Itali. Atje studioi histori e letërsi latine. Mes viteve 1506 e 1510 botoi në Romë të parën histori për jetën e luftërat e Skënderbeut. Mënjëherë, vepra e Barletit u përkthye në të gjitha gjuhët e Europës. Edhe sot kjo biografi e Barletit përbënë burimin më të rëndësishëm historiografik për jetën e heroit më të njohur kombëtar Gjergj Kastriotit.

10. Kur dhe ku u shpall pavarësia e Shqipërisë?



Pavarësia e Shqipërisë u shpall më 28 nëntor 1912 në Vlorë. Ismail Qemali lexoi Deklaratën e Pavarësisë dhe para deputetëve të pranishëm dhe gjithë botës shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Dita e 28 Nëntorit është një festë mbarë kombëtare e shqiptarëve. Brenda kësaj dite historike përmblihen kujtimet e shkruara e të pashkruara të shqiptarëve. Isa Boletini u prit nga vet Ismail Qemali me atë Flamur për të cilën Isa e gjithë Kosova kishin derdhur mund e gjak.

11. Kush u zgjodh Kryetar i Parë i Qeverisë Shqiptare në Vlorë?



Ismail Qemali 1844 – 1919

Ismail Qemali u zgjodh Kryetar shteti, Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Parë shqiptare.

Ismail Qemal Vloza u lind në Vlorë në një familje çifligare më 24 janar të vitit 1844, vdiq në Itali më 24 janar të vitit 1919. Ishte udhëheqës i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kryetar i parë i Shqipërisë së pavarur. Pasi kreu shkollën fillore në qytetin e lindjes dhe gjimnazin "Zosimea" në Janinë, më 1859 u vendos me familje në Stamboll. U aktivizua në lëvizjen patriotike shqiptare: mori pjesë në përpjekjet për caktimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe dhe për formimin e një shoqërie kulturore shqiptare. Ishte njohës i shumë gjuhëve të huaja.

12. Cilat vise shqiptare mbeten jashtë kufijve të shtetit shqiptar dhe kush i okupoi ato?



Kosovën, viset shqiptare në Mal të Zi dhe Maqedoni i okupuan Serbia dhe Mali i Zi, kurse Çamëria dhe disa vise tjera në jug u okupuan nga Greqia.

Në hartën përmbri shihni territorin etnik të shqiptarëve që u copëtua gjatë historisë. Më shumë se gjysma e territorit tonë mbeti jashtë kufijve të shtetit shqiptar që u shpall më 1912.

13. Kur u mbajt Konferenca e Bujanit dhe cilat vendime u morën aty?

Konferenca e Bujanit u mbajt nga 31 dhjetori 1943 deri më 2 janar 1944. Aty u vendos që populli shqiptar i Kosovës, pas mbarimit të luftës, do të vendos vetë për bashkimin e Kosovës më Shqipërinë.

14. Kur u bë Shqipëria anëtare fuqiplote e NATO-s?



Emblema e NATO-s.

Më 7 prill 2009 Shqipëria u bë anëtare e plotë e NATO-s.

Kjo është një ditë historike për mbarë popullin shqiptar pasi që kjo datë shënon arritjet e Shqipërisë në këto dekadat e fundit dhe në të vërtetë integron përgjithmonë popullin shqiptar në familjen e madhe euro-amerikane. NATO-ja u themelua më 4 prill 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë një ceremonie në Uashington. Atëbotë ishin 12 shtete fillestare – dhjetë europiane dhe dy nga Amerika Veriore: Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Britania dhe Shtetet e Bashkuara.

15. Kur u përmbys diktatura komuniste në Shqipëri?



Në Tiranë bie shtatorja e udhëheqësit komunist.

Diktatura komuniste në Shqipëri u përmbys në vitin 1992. Në këtë vit ra regjimi diktatorial, u përmbys shtatorja e udhëheqësit komunist dhe hyri në fuqi sistemi shumë partiak demokratik. Prijëse e ndryshimeve demokratike u bë rinia studenteske dhe qarqet intelektuale të kohës. Sali Berisha u zgjodh kryetar i Partisë Demokratike dhe u formuan edhe parti tjera politike si Partia Republikane, Partia Socialiste etj. Shqipëria, kështu hyri përgjithmonë në rrjedhat e demokracisë perëndimore.

16. Cilit President të SHBA-ve Kosova i ngriti shtatore në Prishtinë ?



Në Prishtinë qëndron bukur shtatorja e Presidentit të SHBA-ve Bill Clinton. Sot shqiptarët e gëzuar, kalojnë krenarë pranë shtatores së tij, e përshëndesin dhe e falënderojnë nga zemra për ndihmën që u dha ai e Amerika në kohën kur Kosova bënte jetë të vështirë. Clintoni dhe Amerika e ndalën dorën vrastare të Serbisë në vitin 1999, kthyen në shtëpitë e tyre refugjatët shqiptarë, ringjallën shpresën e venitur dhe i dhuruan paqen e pavarësinë Kosovës së shumëvujtur. Autor i shtatores është Izeir Mustafa.

17. Kush janë ilirët?



Ilirët janë paraardhësit e shqiptarëve. Ilirët janë ndër banorët më të lashtë të Gadishullit Ballkanik. Ata janë autoktonë. Kulturën, gjuhën dhe tiparet antropologjike ilirët i formuan në vendin e tyre, në pjesën perëndimore të Gadishullit, aty ku shkrimtarët antikë i përmendin në veprat e tyre. Trevat e shtrirjes së popullsisë ilire janë mjaft të gjera; ato përfshijnë të gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, që nga degët e Danubit, lumenjtë Sava e Drava, në veri, e deri te Gjiri i Ambrakisë (Prevezë) në jug, kurse në lindje deri në Vardar.

18. Në cilin vit Kosova krijoi marrëdhënie diplomatike në nivel ambasade me Suedinë?



Kosova emroi ambasadorin e parë në Suedi në vitin 2009. Suedia njohu pavarësinë e Kosovës më 4 mars 2008. Zyra diplomatike e saj në Prishtinë u ngrit në nivel ambasade menjëherë pas njohjes nga Suedia. Ambasadori i parë i Kosovës në Suedi emrohet Lulzim Peci.

19. Cilat janë fiset kryesore ilire?



Fiset kryesore ilire janë dardanët, ardianët, taulantët, epirotët, albanët, enkelejët etj. DARDANËT ishin fisi më i madh ilir dhe shtriheshin në Ballkanin Qendror, kryesisht në Kosovën e sotme. ARDIANËT: Fillimisht shtriheshin rreth gjirit të Rizonit dhe të lumit Neretva, kryeqendër kishin Shkodrën, TAULANTËT: Banonin në zonën e Adriatikut, që nga lumi Vjosa, deri në prapatokën e Durrhahut, EPIROTËT shtriheshin nga lumi Vjosa deri në gjirin e Ambrakisë dhe nga deti Jon deri në malet Pindit. ALBANËT: Banonin në prapatokën e qytetit të Durrhahut. Kryeqendra e tyre ishte Albanopoli (Zgërdheshi i Krujës). Fisi i albanëve i dha emrin e vet shqiptarëve, ENKELEJTË: Banonin në krahinat përreth liqenit të Ohrit.

20. Cila ishte gjuha e ilirëve?

Gjuha e ilirëve ishte ilirishtja. Ilirët flisnin një gjuhë që dallohej nga gjuhët e popujve të tjerë të kohës së lashtë të Ballkanit. Ajo ishte një gjuhë e veçantë indoevropiane. Janë konstatuar elemente të përbashkëta sidomos me trakishten. Lidhur me vendin e ilirishtes në mes të gjuhëve indoevropiane është diskutuar mjaft. Një varg dijetarësh të shquar historianë, arkeologë e gjuhëtarë, kanë sjellë një sërë argumentesh historike dhe gjuhësore për origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Sintezën më të plotë, të shoqëruar me vështrimin kritik të mendimeve për origjinën e gjuhës shqipe, e ka dhënë gjuhëtari i shquar prof. Eqrem Çabej.

21. Cilat ishin qytetet kryesore ilire?

Qytetet kryesore ilire ishin Skodra, Bylisi, Dyrrahu, Apolonia, Ulqini, Ulpiana, Theranda etj. Njoftimet me të hershme të shkruara për ekzistencën e qyteteve në Iliri i takojnë mesit të shek IV para erës së re. Gjatë shek IV-II para erës së re qyteti dhe jeta në Iliri moren një zhvillim të vullshëm. Ato u zhvilluan veçanërisht në krahinat e ultësirës bregdetare, nga Dyrrahu deri në Apolloni. Qytetet ishin të ngritura mbi kodra të mbrojtura nga pikëpamja natyrore e të fortifikuara me mure rrethuese të ndërtuara me blloqe gurësh të punuar. Në vendet më të mira ndërtoheshin ngrehinat e rëndësishme shoqërore si tempujt, portiket, teatrot, stadiumet etj. Në Bylis e Klos u ndërtuan teatro, në Amantie stadiume.

22. Cilët ishin mbretërit më të njohur ilirë?



Mbretëresha Teutë

Mbretërit më të njohur ilir ishin Bardhyli, Pirroja, Longari, Agroni, Teuta etj. Genci ishte mbreti i fundit ilir, mbretëria e të cilit ra definitivisht nën robërinë romake. Agroni dhe Teuta kishin selinë e tyre në qytetin Rizon (afër Ulqinit) dhe kishin flotën më të fuqishme në Adriatik. Mbreti i Dardanisë së dikurshme ishte Longari. Pirroja kishte bashkuar Ilirinë, por në një luftë kishte humbur aq shumë ushtarë sa që prej asaj kohe përdoret shprehja "Fitore e Pirros" – që do të thotë fitore me shumë sakrifica, (humbje të mëdha).

23. Cili fis ilir banonte dikur në territorin e Kosovës së sotme?



Ulpiana- kryeqytet i Dardanisë.

Në territorin e Kosovës së sotme banonte fisi i dardanëve. Në shek. IV p.e. sonë u krijua Mbretëria Dardane, e cila shtrihej në territorin e Kosovës së sotme. Kufijtë e saj shkonin në veri deri të qyteti i Nishit, kurse në jug deri në Kukës dhe në rrjedhën e sipërme të Vardarit. Mbreti i parë dardan që njohim, ishte Longari. Pas tij erdhën mbretërit Bato dhe Monun. Dardania ishte e njohur për punimin e arit dhe përpunimin e produkteve blegto-re. I njohur ka qenë veçanërisht djathi dardan.

24. Në cilët shekuj u vendosen fiset sllave në tokat ilire?

Fiset sllave filluan të vendosen në tokat e ilirëve në shekujt VII e VIII.

25. Kur dhe ku u formua Principata e Arbrit dhe kush ishte Princi i Parë i Arbrit?

Principata e Arbrit u formua në vitin 1190 në tokat midis Durrësit dhe Dibrës, princi i parë ishte Progoni.

26. Kur u shpall Shqipëria republikë?

Më 21 janar 1925, Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë Republikë Parlamentare dhe Ahmet Zogu u zgjodh President i Shqipërisë. Zogu pati shumë pushtet në duart e tij dhe Republika funksiononte më tepër si Republikë Presidenciale në atë kohë.

27. Kur u shpall Shqipëria mbretëri dhe kush u zgjodh Mbreti i Parë Shqiptar?



Mbreti Ahmet Zogu

Më 1 shtator 1925, Shqipëria u shpall Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe Ahmet Zogu u shpall Mbret i Shqipërisë, duke marrë titullin mbretëror “Zogu i Parë”. Mbreti u lind më 8 tetor 1898, në Burgajet –Mat, në një kështjellë të ndërtuar rreth shekullit të XV. Mësimet e para i mori në vendlindje nga mësues privat si Sali Toro, Hysen Efendi Ceka dhe Dervish Hima. Më 1905 largohet për në Stamboll ku fillon studimet në Lice dhe më vonë në akademinë ushtarake deri më 1912. Më 1917 shkon në Vjenë për të studjuar gjuhën gjermane dhe për të thelluar njohuritë në artin ushtarak dhe diplomacinë perëndimore. Mbreti fliste anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, dhe arabisht. Më 9 prill 1939 duke mos pranuar kushtet e pushtimit fashist, largohet nga Shqipëria. Jetoj në Greqi, Turqi, Rumani, Francë, Angli, Egjipt dhe ndërroi jetë në Kanë të Francës në spitalin “Foch”, më 8 prill 1961.

28. Cila është partia e parë politike shqiptare në Kosovën pas komuniste dhe kush ishte kryetar i saj?



Dr Ibrahim Rugova

Partia e parë politike shqiptare në Kosovën pas komuniste është LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) dhe kryetar i parë i saj ishte Ibrahim Rugova. Dr. Rugova u zgjodh më 23 dhjetor 1989 kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së parë politike në Kosovë që sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. Si intelektual me nam i jepte zë kësaj lëvizjeje intelektuale e politike. LDK nën udhëheqjen e Dr. Ibrahim Rugovës, u bë shpejt forca politike prijëse në Kosovë, duke mbledhur shumicën e popullit rreth vetes. Në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë si dhe me Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova dhe LDK-ja përmyllën kornizën ligjore për institucionalizimin e pavarësisë së Kosovës.

29. Kur dhe ku u paraqit për herë të parë UÇK-ja?



Emblema e UÇK.

UÇK-ja (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) u paraqit për herë të parë me 28 nëntor 1997 në Llaushë të Skënderajt. Atëbotë në Llaushë bëhej varrimi i një mësuesi që ishte vrarë ditë më parë nga policët serb. Tre pjesëtarët e UÇK (Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradini) dolën hapur para popullit për të dëshmuar egzistencën e UÇK.

30. Kush është komandanti legjendar i UÇK-së ?



Komandant Adem Jashari

Komandant legjendar i UÇK-së ishte Adem Jashari. Adem Jashari, u lind më 28 nëntor 1955 në Prekaz. Ishte themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pushka e tij ishte krismë e madhe kundër ushtrisë e policisë serbe. Nuk e ndali luftën kurrë për lirinë e Kosovës. Disa herë armiku e sulmoi shtëpinë e familjen e tij. Më 6 mars 1998 u vra së bashku me 50 antarë të familjes pas rezistencës që i bëri ushtrisë e policisë serbe. Adem Jashari mori titullin Hero i Kosovës vitin 2005 nga presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova. Shumë rrugë, shkolla dhe organizata e mbajnë emrin e tij në Kosovë e Shqipëri. Fshati Prekaz sot është destinacion turistik i popullarizuar në Kosovë. Shtëpia e tij e shkatërruar në Prekaz është shndërruar në memorial historik për brezat.

31. Kur filluan sulmet e NATO-s kundër forcave serbe në Kosovë?



Më 24 mars 1999, NATO filloi sulmet ajrore kundër Jugosllavisë me bombardimin e pozicioneve ushtarake serbe në Kosovë e Serbi. Ofensiva e NATO-s erdhi në përgjigje të një vale të re të spastrimit etnik të drejtuar nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Në vitin 1999, ishin Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj në NATO të cilat kryen një fushatë ushtarake, për të ndaluar vendimin e ish presidentit serb Slllobodan Millosheviq për zhdukjen e popullit të pa mbrojtur të Kosovës. Sulmi i NATO-s filloi mbasi i dërguari i Uashingtonit për Kosovën Richard Holbrooke, dështoi në bisedimet për paqe me kryekriminelin serb Slllobodan Millosheviq.

32. Kur u çlirua Kosova?



Kosova u çlirua më 12 qershor 1999. Trupat e NATO-s hynë nga shumë drejtime në tokën e Kosovës. Populli edhe pse i shpërndarë maleve e fushave, i lodhur, i plagosur e i vrarë doli në rrugë dhe priti si çlirimtarë ushtarët e NATO-s. Edhe ushtarët e UÇK hyn triumfalisht në qytete e fshatra të çliruara.

33. Kush u zgjodh kryetari i parë i Kosovës së çliruar?



Kryetari i parë i Kosovës së çliruar u zgjodh Dr. Ibrahim Rugova. Ibrahim Rugova u lind më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cerrcë, komuna e Istogut. Më 10 janar 1945, komunistët jugosllavë pushkatojnë babain e tij Ukë Rugova dhe gjyshin Rustë Rugova. Ibrahim Rugova mbaroi shkollimin e mesëm në Pejë më 1967. Diplomoi në Degën e Albanologjisë më 1971. Zoti Rugova qëndroi gjatë një viti akademik (1976-77) në Paris, në Ecole Pratique des Hautes Etudes, tek profesor Roland Barthes-it. Ibrahim Rugova mori doktoratën në letërsi në Universitetin e Prishtinës më 1984. Më 1996 u shpall doktor nderi i Universitetit të Parisit VIII në Paris. Dr. Rugova u zgjodh më 23 dhjetor 1989 kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), partisë së parë politike në Kosovë. Më 21 janar 2006 vdes Presidenti i Parë i Kosovës, Ibrahim Rugova.

34. Si quhet ushtria që luftoi për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni?



Emblema e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni

Ushtria që luftoi për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni quhet Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Për shkak të represionit sistematik nga ana e pushtetit maqedonas filloi kryengritja e armatosur e shqiptarëve. Palë në konflikt paraqiten forcat e bashkuara të sigurimit të Maqedonisë dhe UÇK.. Konflikti filloi në fshatin Tanushë në fillim të vitit 2001. Më 13 shtator të vitit 2001, liderët e katër partive nga Koalicioni i gjerë, kryetari i shtetit Boris Trajkovski dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare e nënshkruan Marrëveshjen e Ohrit. Kjo marrëveshje për shqiptarët ishte legjitimim i suksese luftarake dhe realizim i qëllimeve të kahmotshme për status të barabartë-popull konstituiv në vend.

35. Si quhet ushtria që luftoi për të drejtat e shqiptarëve në Kosovën lindore?



Emblema e Ushtrisë Çlirimtare e Presheves, Medvegjes dhe Bujanocit.

Ushtria që luftoi për të drejtat e shqiptarëve në Kosovën lindore quhet Ushtria Çlirimtare e Presheves, Medvegjes dhe Bujanocit (UÇPMB). Si rezultat i politikave diskriminuese të shtetit serb lindi organizata ushtarake shqiptare që njihet me emrin "Ushtria Çlirimtare e Presheves, Bujanocit dhe Medvegjes", e cila hyri në konflikte të armatosura me Forcat e Armatosura të Serbisë. Luftoi për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Luginë të Presheves.

36. Cilët janë disa nga personalitetet shqiptare me famë botërore?

Disa nga personalitetet shqiptare me famë botërore janë: Skënderbeu, Aleksandër Moisiu, Nënë Tereza, Ismail Kadare, Xhim Bellushi etj.



Skënderbeu



Aleksandër Moisiu



Nënë Tereza



Ismail Kadare



Xhim Bellushi

37. Kur dhe ku lindi Nënë Tereza?



Nënë Tereza u lind në vitin 1910 në Shkup. Anjezë Gonxhe Bojaxhiu e njohur si Nënë Tereza u lind në Shkup më 26 gusht të vitit 1910. Gonxhja ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut (Nikollë Bojaxhiu) me origjinë nga Prizreni dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Shqiponja e Gjakovës. Është shqiptarja më e dashur, më e adhuruar dhe humanistja më e njohur në botë. Në vitin 1979 fitoi çmimin Nobel për Paqë. Vdiq më 5 shtator 1997 në Kalkuta (Indi).

38. Ku jetoi dhe veproj Nënë Tereza?



Nënë Tereza dhe Papa Gjon Pali i Dytë.

Nëna Tereze jetoi dhe veproi në Kalkuta të Indisë. Nënë Tereza bënte jetë modeste në Indi. Kur Papa Gjon Pali i Dytë i bëri një vizitë në Kalkuta i faloi asaj makinën personale në mënyrë që t'ja lehtësojë punën e përditëshme dhe të mundimshme. Nënë Tereze edhe këtë dhuratë të çmuar e shiti për të ndihmuar të sëmurët e shumë rrugëve të varfëra të Indisë.

39. Cilin çmim të rëndësishëm e fitoi Nënë Tereza dhe kur?



Ajo e mori çmimin Nobel për Paqe në vitin 1979. Ja deklarata e Nënës Tereze me rastin e marrjes së çmimit Nobel: **"Nga gjaku jam shqiptare, nga shtetësia indiane, nga besimi jam katolike, por për të gjithë ata që kërkojnë ndihmën time, i përkas gjithë botës".**

Nënë Tereza merr Çmimin Nobel për Paqe në Oslo të Norvegjisë.

40. Në cilin vit u botua abetarja e parë në gjuhën shqipe dhe kush ishte autori i saj?



Naum Veqilharxhi

Abetarja e parë në gjuhën shqipe u botua në vitin 1844 në Rumani dhe autor i saj ishte Naum Veqilharxhi.

41. Kur u formua “Lidhja e Prizrenit”?



Shtëpia ku u mbajt Lidhja e Prizrenit.

Lidhja e Prizrenit u formua më 10 qershor 1878 në Prizren. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878 - 1881) zyrtarisht filloi me tubimin e përfaqësuesve të të gjitha krahinave shqiptare. Qëllimi i takimit ishte formimi i një shteti autonom shqiptar që do të mbulonte të gjitha vilajetet shqiptare. Lidhja e Prizrenit është ngjarja madhore historike që emancipoi jetën, letërsinë e kulturën tonë kombëtare në përgjithësi.

42. Kush ishin udhëheqësit kryesor të Lidhjes së Prizrenit?



Ymer Prizreni




Sulejman Vokshi



Abdyl Frashëri

Udhëheqës kryesor të Lidhjes së Prizrenit ishin: Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi, Abdyl Frashëri etj.

43. Cila është rëndësia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit?



Lidhja Shqiptare e Prizrenit pati rëndësi të madhe për historinë e popullit shqiptar sepse ishte organizata e parë mbarëshqiptare që luftoi për mbrojtjen e vendit nga copëtimi, formoi qeverinë shqiptare dhe i bëri të njohur shqiptarët në Evropë. Lidhja e Prizrenit është ngjarje me peshë të madhe historike që bashkoi shqiptarët si në kohën e Skënderbeut. Lidhja anticipoi gjithë rrjedhat historike e kulturore të shqiptarëve në fund të shekullit XIX.

44. Kur dhe ku u hap shkolla e parë shqipe?



Shkolla e parë shqipe në Korçë.

Shkolla e parë shqipe u hap më 7 mars 1887 në Korçë.

Në këtë shkollë punuan me përkushtim mësuesit e parë shqiptarë: Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Naçi Nuçi, Thoma Avrami, dhe të tjerë. Shkolla shqipe punoi 15 vjet me rradhë dhe pastaj perandoria Osmane e mbylli, por në këto 15 vjet u shkolluan shumë nxënës të cilët pastaj jo vetëm se u bënë pishtarë të arsimit, por edhe luftëtarë të flaktë për lirinë e Shqipërisë. Prandaj 7 marsin e kujtojmë me respekt të thellë për këta mësues të parë shqiptarë që na lanë testament gjuhën shqipe. Këtë respekt e kemi dhe duhet ta kemi edhe në të ardhmen për mësuesit që sot e mbajnë gjallë gjuhën edhe në diasporë.

45. Kur u formua Lidhja e Pejës dhe kush ishte udhëheqës i saj?



Haxhi Zeka

Lidhja e Pejës u formua në vitin 1899 dhe udhëheqës i saj ishte Haxhi Zeka. Më 23 janar 1899 nën kërcënime të reja për tokat shqiptare në Pejë u mbledh një kuvend me 500 pjesëmarrës nga vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe të Janinës. Në kuvendin gjashtëditor zuri fill Lidhja e Pejës ose siç u quajt ndryshe Besa-Besë. Kuvendi u organizua dhe u drejtua nga Haxhi Zeka. Kuvendi doli me një program 11 pikësh i cili kundërshtonte përpjekjet për të copëtuar tokat shqiptare.

46. Cilët ishin udhëheqësit kryesor të kryengritjeve në vitet 1910, 1911 dhe 1912?



Idriz Seferi



Isa Boletini



Dedë Gjo Luli



Bajram Curri

Udhëheqës kryesor në kryengritjet e viteve 1910, 1911 dhe 1912 ishin: Idriz Seferi, Isa Boletini, Dedë Gjo Luli, Bajram Curri etj.

47. Me cilën datë festohet dita e flamurit të Suedisë?



Dita e flamurit të Suedisë festohet me 6 qershor.

48. Në cilat vite Suedia dhe Norvegjia jetuan në union të përbashkët si Mbretëri të bashkuara?

Dy shtetet nordike Suedia dhe Norvegjia krijuan një Mbretëri të përbashkët më 14 janar të vitit 1814. Unike jetuan deri në vitin 1905. Në vitin 1905 Norvegjia pavarësohet nga Suedia dhe kështu shuhet përgjithmonë unioni.

49. Cili mbret i njohur suedez vuri themelet e shtetit nacional dhe konsiderohet baba i kombit suedez?



Mbreti Gustav Vasa

Mbreti që vuri themelet e shtetit nacional dhe që konsiderohet si baba i kombit suedez është Gustav Vasa. Gustav Vasa, i njohur edhe si Gustavi I, lindi me 12 maj 1469 në Vallentuna dhe vdiq me 1560 në Stokholm. Ishte mbret i Suedisë nga viti 1523 deri në vdekje. Është mbreti i parë që futi monarkinë trashëguese në Suedi. I takon dinastisë Vasa, që është dinastia e parë mbretërore e trashëguar që sundoi Suedinë si një mbretëri të bashkuar. Ai formoi gjithashtu një qeveri të fortë qendrore. Futja e monarkisë trashëguese në Suedi konsiderohet si themelimi i shtetit kombëtar modern të Suedisë. 6 qershori i vitit 1523, datë në të cilën ai u zgjodh mbret nga parlamenti është dita kombëtare e Suedisë. Ai më vonë, veçanërisht nga fundi i viteve 1800, është ngritur në “baba të kombit” dhe kështu është bërë një simbol i rëndësishëm kombëtar.

50. Me cilat shtete europiane kishte lidhje Skënderbeu?



Raguza



Venediku



Napoli

Skënderbeu kishte marrëdhënie shumë të mira me Hungarinë, Raguzën, Vatikanin - papatin, Mbretërinë e Napolit dhe Venedikun.